



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Eidgenössisches Justiz- und Polizeidepartement EJPD
Département fédéral de justice et police DFJP
Dipartimento federale di giustizia e polizia DFGP
Bundesamt für Migration BFM
Office fédéral des migrations ODM
Ufficio federale della migrazione UFM



Mirë se vini në Zvicër

Informacione për të ardhurit e rinj

Përmbajtja

5

Një vend me shumë fytyra

Shumëllojshmëri kulturore në hapësirë të vogël

7

Jeta e përbashkët

Shanse të barabarta dhe respekt

9

Qytetaret dhe qytetarët e kanë fjalën e fundit

Federalizmi dhe demokracia e drejtpërdrejtë

13

Ura për në sukses

Rëndësi e lartë e arsimit dhe e punës

17

Mbajtja e përbashkët e përgjegjësisë

Siguria sociale dhe shëndeti

Mirëseardhje e përzemërt në Zvicër



Simonetta Sommaruga
Këshilltare federale

Ju keni vendosur që të jetoni në Zvicër. Kjo sjell me vete shumë ndryshime. Në krahasim me atdheun tuaj shumë gjëra mund t'ju duken të panjohura. Puna, shkolla, shëndetësia, trafiku dhe shumë gjëra të tjera janë organizuar ndryshe.

Pavarësisht nga fakti se sa kohë do të rrini përfundimisht: Shfrytëzoheni kohën këtu si shans. Në çdo rast ia vlen që ta njohësh Zvicrën. Shumë njerëz që kishin planifikuar vetëm një qëndrim të shkurtër, më në fund kanë ndenjur gjithë jetën e tyre.

Broshura që keni në dorë dëshiron që t'ju mundësojë një hyrje të mirë në jetën e përditshme zvicerane. Kushtet më të rëndësishme për një bashkëjetesë të suksesshme janë informacionet dhe kontaktet shoqërore. Që të orientoheni mirë në jetën e përditshme, ju duhet ta dini gjuhën. Për një fillim të mbarë ju keni nevojë, përveç kësaj, për njohuri mbi aspektet më të rëndësishme të ligjeve, të shoqërisë dhe të shtetit në Zvicër.

Ndoshta jo gjithçka arrihet që në fillim kështu siç e keni përfytyruar. Jo vetëm ju si emigrante ose emigrant jeni vendosur përpara sfidave, por edhe zviceranët dhe zviceranët dhe të gjithë të tjerë që kanë kohë që jetojnë në Zvicër. Jeta e tyre ndryshon gjithashtu, nëse në vendin e punës ose në shkollë paraqiten fytyra të reja dhe ato bien në kontakt me njerëz, të cilët nuk janë ambientuar akoma me zakonet e këtushme.

Që t'i dilet mbanë bashkëjetesës së përbashkët duhet pak kohë. Duhet durim dhe „vullneti i imigrantëve si dhe çiltërsi e popullsisë vendëse“. Kështu shkruhet në ligjin tonë për të huajt.

Informacionet e dhëna duhet t'ju japin një shikim të parë në Zvicër dhe duhet ta hapin derën për ju për një fillim të mbarë.

Mirëseardhje e përzemërt!

S. Sommaruga



Samba Kebbeh (34)

Shoqërues treni
Turbenthal

«Kur unë me njëzet vjeç erdha në Zvicër për shkak të dashurisë sime të atëhershme dhe gruas sime të sotme, shoku kulturor ka qenë i madh. Zvicëranet dhe zvicëranët më të vërtetë ishin të sjellshëm, korrekt dhe të besueshëm - por mua më ka munguar një farë çiltërsie. Kur pastaj nga shumë letrat e mia të konkurrimit u kthyen vetëm refuzime, unë kam kuptuar së Zvicra nuk është një vend përrallor dhe duhet që unë të luftoj për fatin tim. Unë pastaj në mënyrë intensive kam mësuar gjermanisht për një vit të tërë në një shkollë. Kjo ka përmirësuar dukshëm mundësitë e mia dhe para së gjithash vetëbesimin tim.

Që pas vështirësive të fillimit unë jam bërë një zvicëran i kënaqur gambian, për këtë i jam mirënjohës punëdhënësit tim. Ishte ai që kishte besim ndaj aftësive të mia dhe më ka bërë shoqëruesin e parë afrikan të trenit në Zvicër. Sot unë jetoj me kënaqësi në Zvicër dhe ndërkohë unë e konsideroj si pasurim që të jem një përzierje nga dy kultura dhe ta marr më të mirën nga këto.»

Një vend me shumë fytyra

Shumëllojshmëri kulturore në hapësirë të vogël

Të ardhurit gjithmonë kanë kontribuar shumë për mirëqenien në Zvicër. Kështu p.sh. tuneli i Gothardit, një prej boshteve më të rëndësishme të trafikut në Zvicër, ishte ndërtuar kryesisht nga punëtorë italianë. Përveç kësaj mirgante dhe migrantë kanë themeluar shumë nga ndërmarrjet e mëdha që janë të suksesshme sot. Edhe sot ekonomia zvicerane ka nevojë për krahë pune nga jashtë vendit.

Në Zvicër jetojnë njerëz nga rreth 140 kombësi. Çdo person i pestë nuk ka një pasaportë zviceran. Dhe çdo martesë e tretë është sot binacionale. Gjithë popullsia e banimit e Zvicrës numëron pothuajse 7,8 milion persona.

Hapësira tepër e vogël kërkon respekt dhe kujdes

Udhëtarët habiten gjithmonë për distancat e shkurtra në Zvicër. Nga një qoshe për në tjetrën nuk duhen as pesë orë. Një e treta e popullsisë në Zvicër jeton në pesë qytetet e mëdha Cyrih, Gjenevë, Bazel, Bernë dhe Lozanë me aglomeracionet e tyre. Më shumë se gjysma e vendit përbëhet prej maleve. Atje jetojnë vetëm dhjetë për qind të popullsisë. Pra, ne bashkëjetojmë me njeri-tjetrin në hapësirë tepër të vogël. Kjo kërkon nga të gjithë kujdes.

Çdo regjion përkujdeset për vetitë e veta kulturore

Në Zvicër fliten katër gjuhë zyrtare të vendit: gjermanisht, frëngjisht, italisht dhe retoromanisht. Sipas zonës ku qëndroni, ju do të hasni në një gjuhë tjetër dhe do të gjeni mënyra të ndryshme të jetës. Shumëllojshmëria gjuhësore dhe

kulturore është themeltare për Zvicrën. Ajo ka një traditë të gjatë.

Gjuha është e rëndësishme për një integrim të mirë

Shumica e popullsisë jeton në Zvicrën gjermanofolëse. Rreth 70 për qind të popullsisë flasin gjermanishten e Zvicrës. Rreth 20 për qind frëngjisht, 7 për qind italisht. Retoromanisht flitet vetëm në krahina të caktuara të kantonit Graubünden. Në Zvicrën gjermanofolëse gjermanishtja letrare përdoret si gjuhë zyrtare veçanërisht në komunikimin me shkrim. Por gjatë kontaktit gojor flitet një numër i madh dialektesh. Gjuha e përditshme në Bazel dallohet atëherë nga ajo në kantonin e Cyrihut. Bernasit flasin ndryshe nga Friburgasit. Nuk është e nevojshme që ju të mësoni të flisni në mënyrë të përsosur të folmen, por ju do ta keni shumë më të lehtë në jetën e përditshme, nëse mësoni që ta kuptoni dialektin. Njohuri gjuhësore janë një kusht i nevojshëm që të ambientoheni mirë në jetën e përditshme si dhe në botën e punës.



Sabri Aliu (46)

Bashkëiniciatori Takimi i baballarëve
Cyrih

«Komshiu im është zviceran. Ai ishte personi që na ka futur në jetën e kolonisë dhe i cili ka bërë që dokeve kosovare t'ju jenë shtuar edhe të tilla si ato zvicerane. Ai e bënte këtë thjesht përmjet njerëzish dhe pa paragjykim. Këtë nuk do t'ia harroj kurrë. Sidomos edhe për shkak të pesë fëmijëve të mi. Unë desha t'u mundësoj atyre një fillim të mbarë këtu në Zvicër.

Kolonia jonë do të thotë për mua shumë më shumë sesa vetëm një çati mbi kokën. Kjo sigurisht ka të bëjë edhe me këtë që njerëzit, të cilët jetojnë këtu, pak nga pak kanë kuptuar që një bashkëjetesë e kënaqur kërkon angazhimin e të gjithëve prej nesh, dhe kjo ka të bëjë

diçka me secilin prej nesh. Qoftë zviceran ose i huaj, qoftë i moshuar ose i ri: Duhet të fillosh të bisedosh me njëri-tjetrin. Sepse vetëm kështu mund të ndryshohet diçka së bashku. Duke u nisur nga ky gjykim u krijua takimi ynë i baballarëve, ku ne baballarët takohemi një herë në muaj për të shkëmbyer mendimet tona dhe për t'u hyrë çështjeve bashkërisht. Kjo e ka thjeshtësuar jetën tonë të përditshme. Dhe lidhur me këtë më e mira është: Nga komshinj janë bërë miq.»

Shanse të barabarta dhe respekt

Kontakte me komshinjtë tuaj të rinj ose bashkëveprimi në një organizatë ose një shoqatë në komunën tuaj përbëjnë një pasurim personal. Gjatë kësaj ju merrni edhe informacione, të cilat ju ndihmojnë ju dhe familjen tuaj në shkollë dhe në vendin e punës ose në lidhjen e kontaktit me zyrat ose autoritetet kompetente.

Të ardhurit kontribuojnë si për pasurinë ekonomike ashtu edhe për atë kulturore të Zvicrës. Që bashkëjetesa e përbashkët të jetë e suksesshme pritet nga të gjithë banueset dhe banuesit e vendit tonë që ata të merren vesh me njëri-tjetrin dhe mundohen që të jenë financiarisht të pavarur. Për një bashkëjetesë paqësore duhet gjithashtu që të respektohet rendi juridik zviceran si dhe vlerat themelore të kushtetutës. Po ashtu të gjithë duhet të kenë shanse të barabarta që të marrin pjesë në jetën shoqërore.

Të drejta të rëndësishme themelore në Zvicër:

Në Zvicër të drejtat themelore garantojnë që ju nuk duhet të diskriminoheni për shkak të prejardhjes suaj, racës, gjinisë suaj ose fesë ose për shkak të orientimit tuaj seksual. Gra dhe burra kanë të drejta të barabarta dhe mund të zgjedhin lirisht p.sh. profesionin e tyre dhe mund të caktojnë vetë bashkëshortin ose bashkëshortin e tyre. Çdo njeri ka edhe të drejtën që të zgjedhë lirisht fenë dhe botëkuptimin e vet. Por të njëjtën

të drejtë duhet që secili t' ia pranojë bashkëqytetarit të tij. Secila dhe secili mund të mbrohet kundër diskriminimit eventual. Në rastet e konflikteve ka këshillimore të cilat ju ndihmojnë që të gjeni zgjidhje.

Krahas ligjeve të shkruara ka edhe rregulla të pashkruara

Shpesh herë janë çështjet e vogla e jetës së përditshme ato që janë të rëndësishme për bashkëjetesën e njerëzve. Vetëm njohja e këtyre rregullave të jetës së përditshme shpesh herë është e vështirë. Për shembull: Ndoshta në shtëpinë tuaj ekziston një plan i caktuar, i cili përcakton, kur cila familje mund t' i lajë rrobat e saj. Atëherë ju duhet t' i përmbaheni këtij. Ose komshinjtë reagojnë nëse edhe në mbrëmje të vonshme bëhen diskutime me zë të lartë në ballkon ose fëmijë luajnë në hyrjen e pallatit. Pritet nga ju që ju t' i respektoni këto rregulla të shkruara ose të pashkruara të bashkëjetesës. Informohuni. Pyesni për shembull për rregulloren e banesës ose merrni kontakt me komshinjtë tuaj. Respekt i ndërsjellë dhe diskutimi i hapur janë tashmë hapi i parë për një fqinjësi të mirë.

① Banimi në Zvicër

Informacione

→ www.bwo.admin.ch

> Dokumentation > Publikationen

> Infoblatt Wohnen > Infoblatt

① Diskriminimi dhe racizmi

Pikat e kontaktit

→ www.edi.admin.ch/ara

> Anlauf- und Beratungsstellen



Anna Gruber (20)

Studente, anëtare e këshillit të të rinjve
Friburg

«Të caktosh qëllime në mënyrë të vetëdijshme, të mos i humbasësh nga sytë dhe gjatë kësaj t' i qëndrosh besnik vetvetes. Kjo është e saktë për mua ashtu edhe për Evën, e cila gjatë kohës së shkollës primare ka ardhur nga Maqedonia tek ne në Zvicër. Vetëm se ajo si e huaj tetëvjeçare e kishte shumë më të vështirë. Por Eva mësonte shpejt. Edhe ne bashkë me atë. Ajo stërvitej veçanërisht në gjuhën gjermane dhe ne në kujdes dhe durim. Ne mësonim bashkërisht dhe njëra prej tjetrës. Kështu ne jemi rritur në aspektin njerëzor. Edhe në parlamentin rinor diskutohen tema për integrim. Mua më shqetëson gjithmonë pak se fjala integrim shpesh herë reduktohet në

të mësuarin e gjuhës ose në mbajtjen ose mosmbajtjen e shamisë së kokës. Por integrim do të thotë shumë më shumë. Për këtë duhen njerëz që kanë vullnet të pranojnë një vend të ri dhe një kulturë të huaj. Dhe nga ana tjetër ka nevojë për një shoqëri që e lejon këtë. Mirëkuptimi dhe toleranca e ndërsjellë nuk mund të urdhërohen me ligje.»

Qytetaret dhe qytetarët e kanë fjalën e fundit

Federalizmi dhe demokracia e drejtpërdrejtë

Në Zvicër është e rëndësishme që të njiheni sa më shpejt që të jetë e mundur me jetën në kantonin tuaj dhe në komunën tuaj. Atje merrni informacione të para për të gjitha fushat e rëndësishme të jetës si banimi, puna dhe shkolla. Para së gjithash ju gjeni partnerë kontakti dhe pika kontakti që mund t'ju përgjigjën pyetjeve tuaja.

Që të dini se si Zvicra është e organizuar në vend, nga shkolla nëpërmjet taksave deri tek të drejtat dhe detyrimet e veçanta, ju keni nevojë për informacione bazë mbi shtetin dhe të drejtën.

26 kantone të pavarura e formojnë Zvicrën

Zvicra përbëhet nga 26 shtete të federatës, të ashtuquajtura kantone. Më përpara kantonet kanë qenë plotësisht të pavarura. Ato pak nga pak janë bashkuar në Zvicrën e sotme dhe i kanë kaluar disa kompetenca federatës. Por në shumë fusha kantonet vazhdojnë të jenë gjerësisht të pavarura. Ato për shembull kanë kushtetuta dhe ligje të veta, por këto nuk duhet të bien ndesh me legjislacionin e federatës. Ato po ashtu kanë parlamente, qeveri dhe gjykata të veta.

Shumë gjëra ndryshojnë nga kantoni në kanton

Kjo pavarësi e kantoneve është një veçori e rëndësishme e Zvicrës. Ju do ta hasni herë pas here në jetën e përditshme. Nëse ju shpërnguleni për shembull me familjen tuaj nga një kanton në një tjetër, atëherë ka

mundësi që fëmija juaj në shkollë do të mësojë pjesërisht çështje të tjera; ose ju nuk paguani më aq taksa sa më përpara, edhe pse paga juaj ka mbetur ende njësoj. Ose sigurimi shëndetësor nuk kushton më njësoj, edhe pse ju mund të shfrytëzoni ende përfitimet e njëlljota.

Federata, kantonet dhe komunitat i ndajnë mes tyre detyrat shtetërore

Zvicra është e ndarë në tre nivele shtetërore. Federata, kantonet dhe komunitat. Lidhur me këtë federata si nivel epror merr përsipër vetëm ato detyra, të cilat kushtetuta federale ia ngarkon shprehimisht. Këtu përfshihen për shembull mbrojtja e vendit ose rregullimi i qarkullimit rrugor. Kantonet merren për shembull me arsimin, policinë, kujdesin shëndetësor dhe për t'ju përballuar këto detyra vjelin edhe vetë taksa. Po ashtu ato rreth 2700 komunitat në Zvicër gëzojnë një pavarësi të madhe. Ato janë kompetente për shembull për kontrollin e banorëve ose marrin përsipër detyra të caktuara në fushën e shkollës.



Bruno Moll (62)

Autor dhe kinematograf i lirë
Bernë

10

«Në filmat e mi dokumentarë bëhet fjalë shpesh herë për politikë në kuptimin më të gjerë të fjalës. Të jesh politik, kjo nuk do të thotë për mua që të biesh në sy me parulla të zhurmshme, por të vëzhgosh me vëmendje. T' i kundërshtosh paragjykimet dhe t' i hapesh, jo t' i mbyllesh dyert - ky është interesi im. Jo vetëm si zviceran, por si ndërmjet njerëzish unë do t' i këshilloja një personi të porsaardhur: Që ai të takohet me vendin tonë me kureshtje dhe të mos veçohet brenda njerëzve të llojit të vet. Vetëkuptohet, unë i këshilloj që ta mësojë gjuhën tonë dhe ta studiojë mentalitetin tonë. Unë i uroj atij që ai të shikojë atë që lidhet dhe jo vetëm atë që veçon. Ai

duhet të shtrojë pyetje dhe duhet ta kërkojë bisedën me popullsinë. Ai duhej të ngjitej patjetër në malet tona dhe të dielave duhet të përzihet me popullsinë që bën xhiron. Ai duhej të blinte nëpër pazaret javore dhe të lexonte, shikonte dhe dëgjonte mediat tona. E thënë thjeshtë: Ai duhet të përpiqet që të mbërrijë këtu. Të gjitha këto unë ua uroj natyrisht edhe neve vetë, vendasve.

→ **Popullsia gëzon një të drejtë të madhe për të marrë pjesë në vendosje**

Forma e shtetit e Zvicrës është demokracia e drejtpërdrejtë. Popullsia me të drejtë vote nuk mund të zgjedhë vetëm rregullisht deputetët në parlamente në nivelin e federatës, të kantonit përkatës dhe në komunë, por mund të votojë për shumë çështje - për shembull për lartësinë e taksave dhe tatimeve, trasetë e rrugëve ose shërbimet e postës, por edhe për aderimin në organizata ndërkombëtare ose marrëveshje me shtete të tjera. Zvicranet dhe zvicranët që nga mosha 18 vjeç/e mund të zgjedhin dhe votojnë për çështje që i takojnë gjithë Zvicrës.

Pjesëmarrja është e rëndësishme dhe e mirëpritur

Në Zvicër ka shumë forma për t' u angazhuar. Për shembull mund të merrni pjesë në një këshill të prindërve. Përveç kësaj të gjithë personat me aftësi gjykimimi mund t' u drejtojnë autoriteteve lutje, propozime dhe ankesa, kjo mund të bëhet p.sh. në formë të një peticioni (mbledhja e firmave). Në pak kantone dhe komuna ju pas qëndrimit më të gjatë keni edhe të drejta politike si për shembull të drejtën e zgjedhjes dhe atë të

votimit. Informohuni në komunën ku banoni ju.

Të gjitha forcat e rëndësishme politike janë përfaqësuar në qeveri

Qeveria e Zvicrës përbëhet nga shtatë anëtarë dhe quhet Këshilli Federal. Këshilli Federal zgjidhet nga parlamenti dhe përbëhet nga përfaqësuese dhe përfaqësues të partive të mëdha politike. Një anëtar i Këshillit federal përcaktohet nga parlamenti për një vit si presidente ose president. Parlamenti përbëhet nga dy dhoma: Këshilli Nacional, i cili përfaqëson popullin, dhe Këshilli i kantoneve, i cili i përfaqëson kantonet. Të dy së bashku formojnë Mbledhjen e Përbashkët të Federatës.

Të drejta dhe detyrime të barabarta për të gjithë

Zvicra është shtet juridik. Kjo do të thotë se jo vetëm banoret dhe banorët e vendit tonë duhet t' i respektojnë ligjet, por edhe shteti vetë është i lidhur në të drejtën në fuqi. Gjykatat janë të pavarura nga qeveria dhe parlamenti. Cilat të drejta dhe detyrime themelore janë këtu në fuqi dhe si është e organizuar Zvicra, kjo shkruhet në kushtetutën federale të Zvicrës.



Vasco Belo (31)

Familje zvicerano-portugeze
La Chaux-de-Fonds

«Formimin profesional, siç praktikohet në Zvicër, unë konsideroj shembullore. Ai ua lehtëson shumë të rinjve kalimin nga bota e arsimit në atë të punës. Në vendin e prejardhjes sime Portugali kualifikimi ndërmjetësohet vetëm përmes shkollave, gjë që ka si pasojë që ata që nuk e vizitojnë shkollën e mesme, nuk disponojnë mundësi të mira zgjedhjeje.

Për ne ka shumë rëndësi që t' u ofrojmë fëmijëve tanë një të ardhme të mirë. Kësaj i përket që ne marrim pjesë në shkollë dhe në kualifikim dhe të përkrahim çdo fëmijë në aftësitë e tij. Sepse kush nuk ka asnjë kualifikim mbetet shpejt pa punë - atëherë nuk luan asnjë rol nga është njeriu.

Në familjen tonë ne flasim vetëm frëngjisht - gjë që më vjen pak keq. Meqenëse gruaja ime është zvicerane dhe nuk flet portugalisht dhe unë vetë jam rritur në Romandi, kjo thjeshtë ndodhi kështu. Por ne kemi akoma festat tona portugeze në familjen tonë dhe pushimet në Portugali, ku fëmijët e kanë të lirë hyrjen në gjuhën time amtare në formë loje.»

Ura për në sukses

Rëndësi e lartë e arsimit dhe e punës

Një formim i kualifikuar pas mbarimit të shkollës së detyrueshme është i zakonshëm në Zvicër. Rreth nëntëdhjetë për qind të të gjithë të rinjve fitojnë një diplomë profesionale ose akademike. Kjo i ngreh shanset në tregun e punës dhe fleksibilitetin në jetën e mëvonshme të punës.

Arsimi dhe puna kanë një rëndësi të madhe në Zvicër. Të gjithë fëmijët dhe të rinjtë, por edhe të gjithë të rriturit duhet të nxiten sipas aftësive të tyre.

Nxitja që nga lindja

Për fëmijët zhvillimi gjuhësor është me rëndësi të madhe. Nxitja e hershme jep një kontribut të rëndësishëm për barazinë e shanseve. Ka shumë mundësi që fëmija juaj ta mësojë gjuhën e vendit para shkollës: për shembull „çerdhe fëmijësh“ (kujdeset për fëmijë në moshën parashkollore që nga mëngjesi deri në mbrëmje), dhe „grupe ku luajnë fëmijë“ (kujdeset me orë për fëmijë në moshën parashkollore dhe ata udhëzohen si të luhen lojëra). Këto institucione publike dhe private marrin përsipër pjesërisht përkujdesjen për fëmijën tuaj deri në hyrjen në shkollën e detyrueshme, por edhe më vonë në mënyrë plotësuese për mësimin në shkollë (p.sh. dreka për fëmijë, mbështetja për detyrimet e shtëpisë). Vizita e këtyre institucioneve është e sprovuar. Në shumicën e rasteve ajo është me pagesë dhe duhet të paguhet

nga prindërit, ku tarifat shpesh herë janë të shkallëzuara sipas të ardhurave të prindërve.

Kopshti i fëmijëve përgatit për shkollën

Kopshti i fëmijëve sipas kantoneve pranon fëmijë nga tre deri në pesë vjeç. Vizita e kopshtit publik të fëmijëve është falas. Në shumicën e rasteve ofrohen dy vjet. Në disa vende edhe kopshti i fëmijëve është i detyrueshëm; por edhe atje ku vizita është vullnetare, e vizitojnë gati të gjithë fëmijët. Kjo është një përgatitje e rëndësishme për shkollën e detyrueshme. Ju lutemi, shfrytëzoni këtë ofertë. Kontakti me fëmijë të tjerë e ndihmon fëmijën tuaj që t' i zgjerojë aftësitë e tij gjuhësore dhe aftësitë sociale. Me rëndësi për njohuritë gjuhësore të fëmijës suaj është edhe që të flisni edhe më tej në shtëpi në gjuhën tuaj amtare.

Si funksionon shkolla?

Komuna e përcakton fëmijën tuaj, sapo ai të ketë arritur moshën për hyrjen në shkollë, për një shkollë në afërsi të vendit tuaj të banimit dhe i informon prindërit me shkrim mbi vendin.

① **Informacione dhe adresa për sistemin shkollor në Zvicër**

→ www.edk.ch

Political bodies > To the list of EDK members

→ www.educa.ch

Bildungsszene > Bildungssystem der Schweiz

① **Mbështetja në zgjedhjen e profesionit**

Konsultim për zgjedhjen e profesionit

→ www.berufsberatung.ch

① **Formimi profesional**

Informacione për formimin themelor profesional

→ www.berufsbildungplus.ch

→ Në Zvicër të gjithë fëmijët e vizitojnë shkollën e detyrueshme. Shkolla publike ofrojnë një arsim bazë falas dhe shumë të mirë në aspektin cilësor në vëllimin prej nëntë viteve. Shkolla e detyrueshme është e ndarë në një shkollë primare dhe një shkollë sekondare I: Shkolla primare zgjat, si rregull, gjashtë vjet. Pastaj ndjekin tre vjet shkollë sekondare I, ku nxënëset dhe nxënësit mësohen në grupe sipas aftësive. Në Zvicër kantonet janë përgjegjëse kryesisht për arsimin. Organizimi nuk bëhet kudo njësoj. Informohuni me kohë në komunën tuaj.

Oferta plotësuese të nxitjes

Nxënëset dhe nxënësit me një nevojë të përcaktuar të nxitjes marrin në kuadër të shkollës së detyrueshme mbështetje falas. Për fëmijë me njohuri të pamjaftueshme në gjuhën e shkollës ekzistojnë gjithashtu oferta të veçanta të nxitjes. Jashtë shkollës ka edhe oferta për mësimin në gjuhën amtare. Pyesni për shembull në shkollën tuaj ose tek organizatat e bashkësisë suaj gjuhësore për ofertat e mësimin në „Gjuhë dhe kulturë amtare“.

Pa prindërit nuk bëhet

Në kopshtin e fëmijëve dhe në shkollë zhvillohen rregullisht mbrëmje informuese për prindërit. Nga prindërit pritet që ata ta shfrytëzojnë mundësinë për të folur me persona

mësimdhënës mbi fëmijën e tyre dhe mundësitë e tyre të arsimit. Nëse ju nuk kuptoni mirë një gjuhë lokale, pyesni për përkthime ndërkulturore.

Pas shkollës së detyrueshme

Një diplomë në shkollën sekondare II është shumë e rëndësishme për të ardhmen profesionale dhe sociale të fëmijës suaj në Zvicër. Për atje çojnë rrugë të ndryshme, në plan të parë këto të dyja: kualifikimi në një profesion të caktuar, i ashtuquajtur „kualifikim profesional bazë“ në një ndërmarrje mësimore ose vizita e një shkolle që çon më tej (p.sh. shkolla e mesme e specializimeve, gjimnazi). Vendimin mbi rrugën e formimit e marrin nxënëset dhe nxënësit së bashku me prindërit dhe personat mësimdhënës tashmë rreth fundit të shkollës sekondare I (që nga klasa e 8-të) në bazë të dëshirave të tyre për profesione dhe aftësive të tyre. Këshillimore për zgjedhjen e profesionit dhe qendra informacioni ju mbështesin ju dhe fëmijën tuaj gjatë zgjedhjes.

Në Zvicër formimi profesional luan një rol të rëndësishme

Rreth dy të tretat e të rinjve pas shkollës së detyrueshme bëjnë në Zvicër kualifikimin profesional bazë. Një mësim i tillë kombinon mësimin praktik të një pune në ndërmarrje me formimin në shkollë. Shumica e mësimëve profesionale zgjasin midis

dy dhe katër vitesh. Të rinj me aftësi të larta mund të kryejnë në mënyrë plotësuese maturën profesionale. Ajo e hap rrugën për në shkollat e larta të specializuara ose, me një provim shtesë, për në universitete.

Një vend i formimit profesional pas shkollës së detyrueshme

Kërkimi për një vend të formimit profesional duhet të bëhet me kohë, d.m.th. jo më vonë se një vit para mbarimit të shkollës së detyrueshme. Por jo të gjithë të rinjtë gjejnë një vend të përshtatshëm të mësimin profesional. Ata në këtë rast mund të vizitojnë një ofertë ure. Interesohuni tek shkolla ose tek konsultimi për zgjedhjen e profesionit për oferta të përshtatshme.

Kualifikimi dhe kualifikimi i mëtejshëm në shkollën terciare

Shkollat e larta në Zvicër janë ndarë në universitete dhe në shkolla të larta të specializuara (p.sh. shkolla të larta pedagogjike, sociale ose teknike). Kusht për studimet, sipas tipit të shkollës së lartë dhe drejtimit të studimeve, është, si rregull, matura e gjimnazit ose matura profesionale.

Rëndësia e punës

Zelli dhe pavarësia ekonomike konsiderohen në Zvicër tradicionalisht si shumë të rëndësishme për integrimin në shoqëri. Të kesh punë është - krahas mbajtjes financiare

Edhe për të rriturit kualifikimi i mëtejshëm është shumë i rëndësishëm. Ka mundësi të ndryshme për një formim profesional dhe një kualifikim të mëtejshëm profesional. Këto kualifikime kanë fituar gjithnjë e më shumë rëndësi. Kurse të kualifikimit të mëtejshëm ofrohen para se gjithash nga institucione private, por edhe nga ato publike.

të jetës së përditshme - për shumë një kusht për një ndjenjë të mirë të vetëbesimit dhe të prestigjit të tyre social.

Në Zvicër zotëron një e drejtë liberale e punës

Të drejtat dhe detyrimet e punëdhënësit dhe të punëmarrësit përcaktohen në një kontratë pune me shkrim. Në atë janë rregulluar pikat më të rëndësishme si orari i punës, koha e provës, rroga, afatet e anulimit si dhe pushimet. Për disa degë profesionale vlejné rregulla të përgjithshme (kontratë kolektive e punës).

Mesatarisht punohet në Zvicër 42 orë në javë. Por sipas sektorit orari i punës mund të jetë deri në 50 orë (koha maksimale e punës sipas ligjit). Rroga e caktuar me punëdhënësin tuaj është një rrogë bruto. Nga kjo hiqen kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore.

Në Zvicër nuk ka një rrogë minimale të përcaktuar me ligj. Por në shumë degë janë në fuqi rroga minimale për të cilat shoqatat e punëdhënësve dhe sindikatat janë marrë vesh në kontrata kolektive të punës.

Njohja e diplomave

Në Zvicër punëdhënësit u kushtojné shumë rëndësi kualifikimeve zyrtarisht të njohura, d.m.th. diplomave dhe dëftesave të punës. Për të vlerësuar kualifikimin tuaj, të fituar diku

tjetër, ose përvojën tuaj për barazi janë kompetente zyra të ndryshme kontakti. Këto ju informojné për hapat e mundshme të procedurës.

Puna e zeze dëmton të gjithë

Kush punon, por nuk paguan asnjë kontribut për sigurimet shoqërore dhe asnjë taksë, kryen punë të zezë. Puna e zezë është e dënueshme si për punëdhënësit ashtu edhe për punëmarrësit dhe nuk ia vlen. Puna e zeze rrezikon edhe mbrojtjen tuaj personale të sigurimit edhe shërbimet për të tjerët.

Për cilën leje keni nevojë për punën dhe qëndrimin?

Nëse ju si shtetase ose shtetas keni hyrë nga një shtet i Bashkimit Evropian (BE) ose Asociacionit Evropian të Tregut të Lirë (EFTA) për ju vlen marrëveshja e lëvizjes së lirë për persona. Ndërsa nëse ju vini nga një shtet tjetër ose jetoni këtu si person i pranuar përkohësisht ose si refugjat i njohur, për ju vlejné dispozitat e Ligjit të të huajve dhe të azilit. Enti Federal për Migrim BFM ju informon për dispozitat e përgjithshme të cilat vlejné për hyrjen në tregun zviceran të punës, për qëndrimin tuaj ose bashkimin familjar. Kompetente për lëshimin e lejeve janë kantonet. Lidhur me pyetjet për formalitetet e sakta të llojeve të lejeve drejtohuni autoritetit kompetent kantonial, si rregull, zyrës së migrimit.



Mësim në gjuhën amtare

→ www.edk.ch

> Bildungssystem CH >

Kantonsumfragen > HSK-Unterricht



Diploma të huaja

Informacione dhe adresa për njohjen e diplomave të huaja

→ www.opet.admin.ch

Topics > Recognition of foreign qualifications



Puna, qëndrimi dhe familja

Zyra Federale për Emigracionin BFM

→ www.fom.admin.ch > Topics

Autoritete kantonale

→ www.fom.admin.ch

> The FOM > Contact adress >

Cantonal authorities



Yasar Turgut (44)

Mjeke e shtëpisë

Lucernë

«Unë shoqëroj paciente dhe pacientë shpesh herë për vite të tëra. Kjo më jep mundësi që të jem në gjendje t' i vlerësoj më mirë ankesat e paraqitur sesa tek dikush, të cilin unë e shoh vetëm një herë dhe anamnezën e të cilit nuk e njoh. Sepse është kështu që jo vetëm trupi, por i gjithë njeriu merr pjesë në një sëmundje. Atëherë një bisedë personale ose një raport plotë besim mjek-pacient mund të ndikojë shumë.

Sidomos në rast të të huajave dhe të huajve që vijnë në klinikën time private ndryshimet kulturore nuk duhet të nënvlerësohen dhe ato duhet të interpretohen. Rrënjët e mia turke më ndihmojnë që të kuptoj jo vetëm problemet e tyre, por të

kem edhe një përfytyrim të qartë për këto. Për shumë njerëz nuk është e lehtë që të orientohen në sistemin zviceran shëndetësor. Atëherë unë jam vendosur para sfidës për të ndërmjetësuar midis mjekëve të specializuar, spitaleve dhe pacientëve dhe për t' i shoqëruar ata në mënyrë individuale.»

Mbajtja e përbashkët e përgjegjësisë

Siguria sociale dhe shëndeti

Secili mund të preket nga nevoja. Ligji për sigurimet shoqërore bazohet në solidaritet. Prandaj edhe të gjithë kontribuojnë për këto: të shëndetshmit për të sëmurët, të rinjtë për të moshuarit, të pasurit për të varfrit ose persona që rrinë vetëm për familjet.

Zvicra ka një sistem social të ndërtuar mirë. Ai siguron që njerëzit në situata të vështira nuk duhet të vuajnë për një kohë të gjatë nga nevoja materiale.

Solidaritet në njërën anë dhe përgjegjësi vetjake në anën tjetër

Çdo person e ushtron përgjegjësinë për vetveten dhe kontribuon sipas mundësive të tij për përballimin e detyrave në shtet dhe në shoqëri. Këtë e përcakton kushtetuta federale e Zvicrës. Në situata ku kjo nuk arrihet, federata, kantonet dhe komunat e sigurojnë mbrojtjen e nevojshme p.sh. ndaj pasojave ekonomike të pleqërisë, invaliditetit ose sëmundjes, aksidentit ose papunësisë. Që të mund të kryhen këto shërbime është me rëndësi që të gjithë të paguajnë kontributet e tyre për sigurimet si dhe taksat dhe të bëjnë çmos për të hequr vet shpenzimet e jetesës.

Në Zvicër sigurimi shëndetësor është i detyrueshëm.

Kush jeton në Zvicër duhet të lidhë një kontratë për sigurim shëndetësor. Jo më vonë se tre muaj pas marrjes së banimit në Zvicër ju

duhet të keni regjistruar vetveten dhe familjen tuaj tek një sigurim shëndetësor. Sigurimi bazë, i cili në Zvicër është i detyrueshëm për të gjithë të rriturit dhe fëmijët, i mbulon shpenzimet për trajtimin nga ana e mjekeve dhe mjekëve dhe në spitale të caktuara si dhe për shumicën e ilaçeve të udhëzuara nga mjekja apo mjeku. Ju për këtë i paguani sigurimit shëndetësor çdo muaj një prim. Lartësia e këtij primi varet nga vendi ku banoni, nëse dëshironi që të merrni përsipër gjithmonë një pjesë të shpenzimeve dhe nëse dëshironi që të siguronit shërbime shtesë. Trajtime të dhëmbëve për shembull janë shërbime shtesë që nuk janë mbuluar nga sigurimi bazë dhe duhet të paguhet në mënyrë të veçantë.

Në vendin e punës ju jeni siguruar edhe ndaj aksidenteve

Kush punon tetë orë dhe më shumë në javë, sigurohet nga punëdhënësi ndaj aksidenteve. Ky sigurim i mbulon shpenzimet dhe humbjen e fitimit në rast të aksidenteve. Kush punon më pak se tetë orë ose punon në mënyrë të pavarur, duhet të kujdeset vetë për një sigurim ndaj aksidenteve.

→ **Kërkoni një mjek të shtëpisë ose një mjek të shtëpisë ndaj të cilës/cilit keni besim.**

Në Zvicër shumica e njerëzve kanë një mjek të shtëpisë ose një mjek të shtëpisë, të cilën/cilin e vizitojnë rregullisht në rast të sëmundjes dhe të aksidentit. Kjo ose ky, sipas sëmundjes ose aksidentit, do t'ju përcjellë tek një mjek i specializuar ose një mjek e specializuar ose në spital. Drejtpërdrejt në spital duhet të shkonit vetëm në raste emergjente.

Çdo njeri ka të drejtë për paprekshmëri trupore dhe shpirtërore

Në Zvicër është e ndaluar dhe e dënueshme çdo formë e ushtrimit të dhunës. Këtu përfshihen për shembull dhuna shtëpiake, syneti i vajzave ose martesë e detyruar. Nëse ju gjendeni në një situatë nevoje, kërkoni ndihmë në një zyrë kompetente të specializuar.

Mbështetja në pleqëri, për pasjetuesit dhe në rast invaliditeti

Të rritur që nga moshë 18 vjeç/e duhet të sigurohen në mënyrë të detyrueshme tek sigurimi i pleqërisë dhe i të pasjetuarve (AHV) si dhe tek sigurimi kundër invaliditetit (IV) dhe duhet të paguajnë kontribute për këtë. AHV paguan një pension pleqërie për gra që nga moshë 64 vjeçe dhe burra që nga moshë 65 vjeç.

Pas vdekjes së një të afërmi ai paguan edhe pensione familjare. Qëllimi i sigurimit kundër invaliditetit është që t'ju përkrahë njerëzit me një të metë. Lidhur me këtë ai ndihmon personat e prekur që të mund të mbajnë vendin e tyre të punës ose të gjejnë një vend të ri. Nëse të dyja nuk arrihen, IV paguan edhe pensione. Pensionet e AHV dhe IV janë përafërsisht aq të larta sa të janë mbuluar kostot për shpenzimet ekzistencialist të rëndësishme. Nëse nuk ndodh kjo, atëherë mund të kërkohen përfitime plotësuese shtesë.

Nevojat shtesë, të cilat e kalojnë minimumin e ekzistencës, mbulohen me pensionet e arkave të pensionit. Sigurimi tek një arkë pensioni është i detyrueshëm për punëmarrës që nga të ardhura të caktuara (përafërsisht 20000 franga në vit). Punonjës të vetëpunësuar mund t'ju bashkohen vullnetarisht një arkë të pensionit dhe të paguajnë kontribute. Kush përveç kësaj dëshiron të kursejë për një jetë të këndshme në pleqëri, mund t'ju investojë të hollat në të ashtuquajturën shtyllë të tretë tek një sigurim ose një bankë dhe shpërblehet për këtë me zbritje tek taksat.

Çfarë të bëj në rast të papunësisë?

Nëse ju jeni në kërkim të punës ose e humbisni vendin tuaj të punës, atëherë lajmërohuni tek qendra

rajonale për ndërmjetësimin e punës (RAV) në kantonin tuaj. Kjo ju këshillon në gjetjen e një vendi të ri të punës. Asistencë papunësie merrni vetëm kur keni punuar të paktën 12 muaj gjatë dy viteve të fundit (gjendja 2010) ose paraqisni një arsye për çlirim nga detyrimi i pagesës së kontributeve. Të gjithë punonjës të punësuar në Zvicër janë të siguruan në mënyrë të detyrueshme ndaj papunësisë.

Përkrahje shtesë për familjet

Çdo grua që punon ka të drejtë për lejen e lindjes prej 14 javësh si dhe për një kompensim të barrë-lindjes në këtë kohë në lartësinë prej 80 % të rrogës së fundit ose të të ardhurave të fundit. Punëmarrëset dhe punëmarrësit me fëmijë, parimisht dhe pavarësisht nga të ardhurat, kanë të drejtë për shtesa familjare. Këto u aprovohen edhe personave me të ardhura modeste që nuk punojnë.

Qëllimi është që t'ju mundësohet secilit një jetë e denjë njerëzore

Në rastet, në të cilat të ardhurat nuk mjaftojnë për të jetuar dhe asnjë prej sigurimeve shoqërore nuk mund të ndihmojë më, asistencë sociale e mbush boshllëkun. Asistencë sociale është çështja e kantoneve dhe jepet, si rregull, nga komuna ku banoni. Ajo financohet nëpërmjet taksave.

